



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

PROKURORIA
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA

AKTMARRËVESHJE

(për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit)

Në Tiranë, sot më 27.4.2018, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda Tiranë, në mbështetje të neneve 406/d e vijues të KPP, nënshkruhet aktmarrëveshja për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, mes palëve:

1- Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda Tiranë, e përfaqësuar nga prokurori Henrik Ligori;

2- I pandehuri Mikel Shallari, i biri i Edmondit dhe i Smihanës, i datëlindjes 06.11.1993, lindur në Grevë (Skrapar) dhe banues në Tiranë, mbajtësi i kartës së identitetit me numër J31106108C, i mbrojtur nga mbrojtësi i caktuar kryesisht dhe i pranuar prej tij Av.Edlira Naqellari, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, me numër liçence 8130, e pranishme gjatë nënshkrimit të këtij akti.

Më 12.6.2017, mes palëve të sipërpërmendura, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit me drejtësinë, falë së cilës i pandehuri fitoi statusin e "bashkëpunëtorit të drejtësisë". Ai u vendos në mbrojtje të posaçme, sipas dispozitave të ligjit Nr.10 173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë", i ndryshuar me ligjin Nr. 10461, datë 13.9.2011.

I pandehuri Mikel Shallari dhe mbrojtësi i tij u njohën paraprakisht me propozimet e prokurorit për arritjen e një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit dhe normat që parashikon KPP në rastin e një gjykimi të tillë. I pandehuri mori pjesë personalisht në bisedimet e kryera në praninë e mbrojtësit të pranuar prej tij Av.Edlira Naqellari. Bisedimet e kryera u dokumentuan me anën e procesverbalit përkatës, të mbajtur në datën e sotme dhe të nënshkruar rregullisht nga palët, para formulimit të kësaj aktmarrëveshjeje.

I pandehuri Mikel Shallari, me vullnet të lirë dhe i pandikuar nga persona të tretë, i pranon faktet penale të konsumuara prej tij dhe bashkëpunëtorëve të tij, fajësinë, llojin dhe masën e dënimit penal, disponimet për provat materiale dhe pagimin e shpenzimeve procedurale, sikurse do të parashtrihen në vijim:

I- PARASHTRIMI I FAKTEVE PENALE

Më 8.4.2017, rreth orës 20¹⁰, në hyrjen e pallatit "Melrose", që ndodhet në kryqëzimin e rrugës së Kosovarëve me rrugën "Ndreko Rino", në Tiranë, u vra me armë zjarri viktimi Arjan

Cuku, oficer në lirim i Policisë së Shtetit. Në regjistrin e posaçëm të kësaj prokurorie, në të njëjtën datë, u regjistrua procedimi penal Nr.139 dhe u kryhen hetimet e nevojshme për sqarimin e rrethanave të faktit dhe identifikimin e autorit.

Nga hetimet e para të kryera menjëherë pas vendngjarjes, duke studjuar filmimet spontane të kamerave të sigurisë së disa subjekteve private, posaçërisht të shoqërisë "Ndërproshpk", u bë i mundur përcaktimi i itinerarit të largimit të autorit nga vendngjarja deri në afërsi të Sheshit Wilson. Këtu gjurmët humbisnin dhe për hetuesit ishte i paqartë itinerari i largimit të mëtejshëm të tij nga vendngjarja.

Akti i ekspertimit mjekoligjor të kufomës së viktimës Artan Cuku me Nr.154, datë 8.4.2017, konfirmoi se në trupin e tij u konstatuan 4 plagë të shkaktuara nga qitja me armë zjarri, dy tejkuese (nga të cilat njëra në kokë dhe dy depërtuese); në trupin e tij u gjetën dhe u sekuestruan dy predha armë zjarri. Akti i ekspertimit balistik Nr.3533, datë 10.4.2017 provoi se predhat e sekuestruara ishin të kalibrit 7.65 mm, u përkisnin fishekëve luftarakë standard të fabrikuar dhe ishin qitur nga e njëjta armë zjarri. Gjithashtu, mbi to u fiksuan gjurmë të formuara nga 4 viaska, 3 prej të cilave kishin vlerë identifikuese. Ekspertët përcaktuan si shkak të vdekjes shokun e rëndë traumatiko-hemoragjik, si pasojë e plagëve të marra.

Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, më 8.4.2017, u gjetën dhe u sekuestruan 8 gëzhoja, 3 predha, 2 këmisha predhe dhe 1 bërthamë predhe, fakt i pasqyruar në procesverbalet përkatëse të këqyrjes së vendngjarjes dhe të sekuestrimit të provave materiale. Sipas akteve të ekspertimit balistik Nr.3534, datë 10.4.2017 dhe 3922, datë 20.4.2017:

- 6 gëzhoja ishin qitur nga e njëjta armë luftarake standard, e kalibrit 7.65 mm dhe kishin vlera identifikuese;
- 2 gëzhoja ishin qitur nga e njëjta armë luftarake standard, e kalibrit 9 mm (9x19) dhe kishin vlera identifikuese;
- 3 predhat ishin pjesë e fishekëve luftarakë të armëve të kalibrit 7.65 mm, të qitura nga e njëjta armë zjarri; njëra prej tyre ishte e dëmtuar lehtë dhe kishte gjurmë të lëna nga viaskat e armës, tri prej të cilave me vlerë identifikuese, dy predhat e tjera nuk kishin vlera identifikuese për shkak të dëmtimit të tyre;
- 2 këmishat dhe 1 bërthamë predhe nuk kishin vlera identifikuese.

Më 11.4.2017 prokurori udhëhoqi rikëqyrjen e vendngjarjes, për të gjetur prova materiale nisur nga brimat e predhave, të cilat dalloheshin në murin anësor të korridorit hyrës të pallatit. U gjetën dhe u sekuestruan 1 predhe dhe 2 këmisha predhe, të cilat iu nënshtruan ekspertimit balistik. Akti Nr.3926, datë 20.4.2017 provoi se predha u përkiste fishekëve të armëve të zjarrit standard të kalibrit 9 mm (9x19); katër nga gjashtë viaskat e formuara në trupin e saj paraqesnin vlera identifikuese të armës që i pati qitur. Dy këmishat e predhave, sipas eksperteve, duhet t'u përkisnin fishekëve të armëve të zjarrit standard të kalibrit 7.65 mm, por nuk paraqesnin vlera identifikuese.

Akti i ekspertimit kimik të gjurmëkopjesit Nr.3554, datë 10.4.2017 provoi se në materialin e marrë nga dora e majtë e viktimës u konstatua prania e nitriteve dhe nitrateve, të pranishme tek faktorët plotësues të qitjes. Akti i ekspertimit kimik të teshave Nr.3554, datë 13.4.2017 provoi se tek dëmtimet e shkaktuara me armë zjarri mbi xhupin dhe pulovrin e viktimës u vërejt prania e e joneve të oksiduara, si nitrite, nitrate, klorate dhe jone hekuri, të pranishme tek faktorët plotësues të qitjes me armë zjarri.

Nisur nga të dhënat e marra menjëherë pas krimit që provonin se viktima nuk ishte i armatosur, u konkludua se disa nga qitjet drojt tij ishin kryer në distancë të afërt. Ky fakt, së bashku me faktin e pozicionit topografik të brimave hyrëse të predhave, të fiksuara gjatë

këqyrjes së kufomës, tregonin se viktimat kishin reaguar në vetëmbrojtje, duke ngritur krahun e majtë drejt agresorit. Autori e priti viktimën i pozicionuar tek shkallët përballë derës së hyrjes. Gjithashtu, pozicioni i brimave të predhave në pasqyrën e ashensorit dhe çanta e tij e gjetur aty, tregojnë se pas goditjeve të para viktimat tentoi të shpëtojë duke hyrë në ashensor, por ai u ndoq nga autori dhe u qëllua teksa ndodhej brenda tij. Goditjen fatale në kokë, viktimat e mori pasi ridoli nga ashensori, duke tentuar të përleshet me autorin. Ky fakt provohet edhe nga deklaratimet e Zj. Julka Allabaku dhe nga pozicioni topografik i viktimës në vendngjarje, i fiksuar fill pas krimit.


Pas kryerjes së krimit, nisur nga deklaratimet e Z. Alket Cakaj dhe nga pamjet filmike të siguruar nga kamerat e subjekteve private në atë zonë, u këqyr se autori i dyshuar çveshi pjesën e sipërme dhe të poshtme të veshjes sportive, të cilat i hodhi në një kazan plehrash, i cili ndodhej në cepin e rrugës "Zef Jubani". Teshat u gjetën dhe u sekuestruan, si dhe iu nënshtruan ekspertimeve teknike. Duke qenë se i dyshuari u fiksua të largohej duke mbajtur duart në xhepat e pjesës së sipërme të bluzës sportive me zinxhir, me ngjyrë blu dhe bojëqielli, me mbishkrimin "Saller", pikërisht nisur nga gjurmët biologjike të lëna në xhepat e saj, u arrit të ndërtohej profili gjenetik i AND-së së një personi mashkull. Akti i ekspertimit biologjik Nr. 5900, datë 07.06.2017, konkludoi se nga mostrat 1.2 dhe 1.3, të marra përkatësisht nga xhepi i majtë dhe i djathtë i bluzës në fjalë, u ndërtua profili gjenetik i njëjtë, i një personi mashkull. Nga mostra 1.1 e marrë në pjesën e brendshme të jakës dhe në pjesën fundore të mëngëve prodhuan një profil gjenetik mikst, kontribut i të paktën dy personave, nga studimi i të cilit njëri përputhej me profilin gjenetik të personit të dyshuar, të përftuar nga materiali biologjik i marrë prej xhepave të veshjes.

Profili gjenetik i AND-së i personit mashkull, i përftuar nga akti i ekspertimit biologjik i sipërpërmendur, u shpërnda nga ZK Interpol Tirana në zyrat homologe evropiane për të bërë krahasimin me të dhënave e bankave të tyre të AND-së të personave të skeduar me precedentë penalë. Interpol Berna (Zvicër) konfirmoi se ky profil gjenetik AND-je përputhej me atë të një personi të regjistruar në Zvicër, në Kantonin e Zurihut me të dhënat e mëposhtme: **Mikel Shallari**, i biri i Edmondit dhe i Smihanës, lindur më 6.11.1993 në Skrapar (Shqipëri).

Të dhënat e dërguara nga Interpol Berna shoqëroheshin edhe me kartelën daktiloskopike të personit, i cili ishte dënuar në Zvicër dhe kishte vuajtur aty dënimin për shitblerje të lëndëve narkotike, nga data 22.2.2016 deri më 23.6.2016. Pas këtij konfirmimi, profilet përkatëse u krahasuan për siguri edhe nga ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore, të cilët konfirmuan përputhjen e plotë të tyre.

Në këto rrethana, si i dyshuar në rolin e ekzekutorit të krimit, u identifikua Mikel Shallari dhe prokurori urdhëroi vëzhgimin i tij në vende publike. Kur oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore përcaktuan vendndodhjen e tij dhe konfirmuan sigurinë se ai duhej të ishte i dyshuari, në orën 23.⁰⁰ të datës 10.6.2017 u urdhërua ndalimi i menjëhershëm, si person i dyshuar për vrasjen e Artan Cukut, në rolin e ekzekutorit material të krimit. Urdhëri i ndalimit u ekzekutua në orën 23.¹⁰ të së njëjtës date.

Me vendimin Nr.296, datë 13.6.2017, gjykata e shkallës së parë për krime të rënda Tirane caktoi ndaj tij masën e sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i KPP. Nga aktet e procedimit rezultoi se i pandehuri Mikel Shallari nuk ishte person me precedentë kriminalë dhe nuk rezultoi në të dhëna për njohje të mëparshme ose konflikt të tij me viktimën Artan Cuku. Pra, akti kriminal i të arrestuarit Mikel Shallari nuk mbështetej nga ndonjë motiv; për këtë arsye, u dyshua se pas tij mund të qëndronin persona të tjerë, në rolin e organizatorit dhe të shtytësit. I ndaluar u pyet nga prokurori, por fillimisht e mohoi përfshirjen e tij në krim.



Me 12.6.2017, i pandehuri Mikel Shallari shprehu vullnetin për të bashkëpunuar me drejtësinë dhe nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me prokurorin. Një ditë më parë, gjatë pyetjes së tij, ai dha deklarime të hollësishme lidhur me kërkimin e kryer prej tij dhe bashkëpunëtorët e tij, në rolin e organizatorit dhe të shrytësuarit, cilët i identifikoi përkatësisht si Bledar Jambelli (alias Rikardo Muho) dhe Gerti Kajo (alias Kristaq Leci), ky i fundit djali i dajës së të pandehurit. Shpjegimet e tij gjatë marrjes në pyetje u dokumentuan me procesverbal të mbajtur në mënyrë të përmbledhur, pasi u shoqëruan me regjistrimin audio dhe video të të gjithë procesit të marrjes në pyetje.

Gjatë shpjegimeve të tij në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, i pandehuri Mikel Shallari pretendoi se, pas kryerjes së krimit, të dyja armët e përdorura prej tij i fshehu në një vend pranë Unazës së Re Tiranë dhe të nesërmen ua dorëzoi ato organizatorit të krimit. Ky pohim i tij rezultoi pjesërisht i vërtetë, vetëm për faktin e fshehjes paraprake të armëve, por jo për faktin se ia pati dorëzuar organizatorit. Rreth orës 23⁰⁰ të datës 12.6.2017, nëpërmjet shërbimit të rojes, i pandehuri kërkoi përsëri që të kontaktonte me hetuesit. Në takimin që u bë me të nesërmen, më 13.6.2017, i pandehuri pohoi se lidhur me vendndodhjen e armëve, pati gjetur dhe shpjegoi se ato i pati fshehur në rrethinat e Kuçovës, duke i paketuar dhe grupuar në një vend i pak shtrati i lumit Devoll. U urdhërua këqyrja e vendit të pretenduar prej të hetuarit, në praninë e këtij të fundit, ku u gjetën dhe u sekuestruan dy pistoleta: një pistoletë e markës Glock, e kalibrit 9 mm, me numër PCF 695, e pajisur me një krëhër pa fishekë dhe një pistoletë e markës Zastava, e kalibrit 7.65 mm, me numër 38499, e pajisur me një krëhër pa fishekë. Akti i kontrollit të vendeve dhe i sekuestrimit të armëve të krimit u regjistrua audio dhe video, prej nga provohet se silenciatorin e njëres prej armëve ai e pati hedhur në disa ferra aty pranë. Me gjithë kërkimet e bëra, nuk u bë e mundur gjetja e silenciatorit.

Nga akti i ekspertimit balistik të armëve të sekuestruara, me Nr 6497, datë 20.6.2017, rezultoi se të dyja armët e sekuestruara ishin armë luftarake, në gjendje të rregullit teknike, me të cilat mund të kryhej qitje. Ekspertimi provoi se 6 gëzhoja dhe 3 predha fishekësh, të sekuestruara gjatë veprimeve të para hetimore në vendngjarje, ishin qitur nga pistoletë e markës Zastava, e kalibrit 7.65 mm, me numër 38499. Gjithashtu, ekspertët konkluduan se 2 gëzhoja dhe 1 predhë fishekësh, të sekuestruara gjatë veprimeve të para hetimore në ngjarjen e sipërpërmendur, ishin qitur nga pistoletë e markës Glock, e kalibrit 9 mm, me numër PCF 695. Ky akt konfirmoi vërtetësinë e deklarimeve të të hetuarit dhe provoi se armët e sekuestruara ishin armët e përdorura nga i pandehuri gjatë ekzekutimit të krimit të vrasjes të Artan Cukut.

I pandehuri dha nëqimtin e tij për marrjen e kampionit biologjik të pështymës, për të kryer edhe njëherë ekspertimin biologjik për nxjerrjen e profilit gjenetik të AND-së. Akti i marrjes u krye në datën 13.6.2017. Akti i ekspertimit biologjik Nr.9583, datë 4.9.2017 konkludoi se profili gjenetik i Mikel Shallarit është i njëjtë me profilin gjenetik të përftuar nga mostrat e përgatitura me material të marrë nga xhepi i majtë dhe xhepi i djathtë i blazës sportive me zinxhir "Saller", të cilën mbante të veshur i pandehuri në çastin e kryerjes së krimit. Kjo është prova kryesore që i pandehuri është autori material i krimit, fakt i cili më pas u pohua prej tij.

I pandehuri dha shpjegime të hollësishme mbi rrethanat dhe motivin e krimit të vrasjes së shtetasit Artan Cuku. Ai pranoi se përkryerjen e tij i ishin premtuar 20,000 euro nga personi i interesuar, të cilin ai e pati njohur me ndërmjetësimin e djalit të dajës së tij, të pandehurit Kristaq Leci, i cili e konsideronte atë person të rëndësishëm dhe e quante "I madhi" ose "Shefi". Ky person u identifikua më pas prej tij si Bledar Jambelli. Përveç çmimit të mësipërm të krimit, organizatori dhe ndërmjetësi i premtuan të pandehurit se do ta ndihmonin të sistemohej në Gjermani, atje ku banonin ata. Ndonëse fillimisht hezitoi, i pandehuri pranoi ta kryente këtë

Bledar Jambelli, i cili i dha 2'000 (dymijë) euro, si shpërblim për krimin e kryer. I pandehuri mësoi se, po atë pasdite, të pandehurit Jambelli dhe Leci do të largoheshin për në Greqi.

Shpjegimet e të pandehurit dhe atribuimet e tij në ngarkim të organizatorit dhe ndërmjetësit të krimit, mbështeten nga prova të tjera, të pavarura objektivisht, të cilat konfirmojnë vërtetësinë e tyre, duke plotësuar kështu kriteret që vendos neni 152.3 i KPP. Ndonëse bashkëpandehurit Jambelli dhe Leci, kanë bërë kujdes që të mos lenë gjurmë në sistemin e regjistrimit të shtetasve, në hyrje dhe në dalje të kufirit të RSH (TIMS), duke kaluar jashtë pikave të kontrollit kufitar, një sërë provash me dëshmitarë provojnë se ditët kur përgatitej krimi ata ndodheshin në Tiranë. Ky fakt provohet nga deklaratimet e disa personave, që i kanë njohur ata gjatë paraqitjes për njohje me fotografi.

Armët e krimit, të fshehura përkohësisht pranë "Astir-it", në Unazën e Re Tiranë, i pandehuri Shallari i mori pas disa ditësh dhe i transportoi në Kuçovë, ku pasi i pakëtoi i fshehu në një vend në shtratin e lumit Devoll. Këqyrja e vendit, me ndihmën e të pandehurit, bëri të mundur gjetjen dhe sekuestrimin e armëve të krimit, fakt i dokumentuar me procesverbalet përkatëse dhe i shoqëruar me regjistrime filmike.

Provohet se i pandehuri Mikel Shallari, ka marrë me qira automjete me të cilat vëzhgonte viktimën nga data 26-28 mars 2017, me një Golf të bardhë me targë AA 719 OX dhe 28 mars - 4 prill 2017, me një Fiat Evo të zi, me targë AA 145 PF, sipas porosisë së të pandehurve Jambelli dhe Leci. Ky fakte provohen nga kontratat e qirasë të lidhura me deklaruesin Dhurim Demiri. Ky i fundit provon faktin se Fiat Evo ishte fikur një ditë në rrugën e "Kosovarëve", fare pranë pallatit "Melrose" ku banonte viktimja; për rindezjen e makinës në atë vend ka shkuar, sikurse dëshmon vetë, deklaruesi Marsel Lezo, shok i afërt i Shallarit dhe punëmarrës tek servisi i Dhurim Demirit. Vetë i pandehuri Shallari pohoi se ky fakt ka ndodhur një ditë para ngjarjes, më 7.4.2017, ndërsa po largohesh së bashku me Kristaq Lecin, pas tentativës së dështuar për të vrarë Artan Cukun, sikundër e përmendëm më sipër.




Provohet se të pandehurit Shallari i janë dërguar të holla për të shlyer borxhet e tij nga i pandehuri Kristaq Leci. Kështu, nga 17.2.2017 deri në 20.3.2017 ai ka marrë katër dërgesa nëpërmjet Unionit Financiar Tiranë, në shumën 500 euro. Një dërgesë tjetër prej 184 eurosh nga Kristaq Leci, ai e ka marrë më 11.5.2017.

Gjatë muajit qershor 2017, para arrestimit, i pandehuri Kristaq Leci i ka dërguar nga Gjermania, përmes kompanisë AK Invest shumën prej 300 eurosh, me dy dërgesa: më 6.6.2017 - 62 euro dhe më 7.7.2017 - 238 euro. Provohet gjithashtu se, në dy raste, i pandehuri Kristaq Leci ka dërguar të holla në adresë të deklaruesit Marsel Lezo, shok i afërt i të pandehurit Shallari, me dy dërgesa: 24.5.2017 - 284.00 euro dhe 30.5.2017 - 384.00 euro. Këto fakte provohen nga faturat e sekuestruara pranë kompanive të transferimit të parave.

Deklaruesi Marsel Lezo e ka pranuar faktin e tërheqjes së parave për llogari të të pandehurit Shallari dhe pranon se të hollat i ka marrë ky i fundit, por pa ditur arsyen pse ishin dërguar.

Lidhur me faktin e marrjes së të hollave të nisura me shoqëritë e dërgimit të shpejtë të parave, i pandehuri pohon se Kristaq Leci nuk kishte asnjë detyrim ndaj tij. Kështu që ka qenë i ndërgjegjshëm që këto të holla atij i dërgoheshin nga i pandehuri Jambelli, i cili i detyrohej për premtimin prej 20'000 eurosh, si shpërblim për vrasjen e Artan Cukut.

I pandehuri shpjegoi edhe motivin e krimit nga i pandehuri Bledar Jambelli dhe nga bashkëpunëtori i tij Kristaq Leci, mësoi se viktimja e pati arrestuar të pandehurin Jambelli, si të dyshuar për vrasjen e shtetasit Amarildo Delaj. Ky fakt provohet se ka ndodhur në kohën kur viktimja kryente detyrën e Drejtorit të Policisë Vlorë. I pandehuri Jambelli arrestimin e tij e



quante të padrejtë, të nxitur nga persona të tjerë dhe ky ishte motivi që ai kishte vendosur që ta vrishte viktimën Artan Cuku, duke u shprehur me fjalë fyese për të. Ky shpjegim i të pandehurit, mbështetet nga provat dokumentare të mëposhtme:

- Shkresa Nr. 2/370-1 Prot., datë 1.3.2018 e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DP të Policisë së Shtetit, e cila provon se nga data 4.2.2012 deri më 9.10.2013, viktima ka shërbyer si Drejtor në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, me gradën policore Drejtues i Parë;

- Aktet e marra nga prokuroria dhe gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë dhe nga IEVP Vlorë dhe Rogozhinë, të cilat provojnë se i hetuari Bledar Jambelli është ndaluar më 7.12.2012, me inisiativë të policisë gjyqësore, si i dyshuar për vrasjen e shtetasit Amarildo Delaj, krim i kryer në Vlorë. Ai u lirua më 9.6.2014, pas deklaratimit si i pafajshëm nga gjykata.

- Aktet e marra nga gjykata administrative e shkallës së parë Vlorë, prej nga provohet se me vendimin Nr.2104 datë 15.12.2016, paditësi Bledar Jambelli (Rikard Muho) është dëmshpërblyer me shumën 517.000 lekë, për periudhën e paraburgimit të vuajtur padrejtësisht.

Faktet objekt akuze në ngarkim të të pandehurit Mikel Shallari provohen nga edhe nga deklaratimet e shtetasve Xhesjana Mëshilli, Marsel Lezo, Dhurim Demiri, Afërdita Halili, Julka Allabaku, Ilir Allabaku, Zade Liçi, Sadete Alla, Artur Kalemaj, Dodë Doçi, Marjola Cuku, Enver Shehu, Ilir Haxhi, Shkëlqim Kalemaj, Alket Cakaj, Edmond Pjetraj, Vasil Bifsha, Gledis Nano, Artan Pjetërnikaj, Xhensila Doko, Aurora Doka, Xhenildo Gogo, Namik Xhindoli, Metjon Demiraj, Redona Shallari, Adenisa Domi.

Lidhur me sa parashtroam, provat në ngarkim të të pandehurit Mikel Shallari janë të mjaftueshme për të konkluduar se ai është ekzekutori material i krimit të vrasjes të viktimës Artan Cuku, krim i porositur dhe i kryer në bashkëpunim me të pandehurit Bledar Jambelli dhe Kristaq Leci. Sikundër parashtroam, Mikel Shallari nuk ka pasur njohje me viktimën, ndaj e vetmja mundësi është shpjegimi i tij se krimi është porositur, kundrejt pagesës dhe përfitimeve të tjera nga bashkë të pandehurit Jambelli dhe Leci, për shkak të ndalimit të Jambellit dhe mbajtjes në paraburgim nga 7.12.2012 deri më 9.6.2014, fakt për të cilin ai ngarkonte me përgjegjësi viktimën. Pra, krimi lidhet me detyrën që kryente viktima si Drejtor i DPQ Vlorë në ato vite.

II- AKUZA DHE PRANIMI FAJËSISË

Në përfundim të hetimeve paraprake lidhur me procedimin penal Nr.139/2017, pandehuri Mikel Shallari u akuzua se:

1- Në rolin e ekzekutorit material, kundrejt një pagese prej 20,000 eurosh dhe përfitimeve të tjera të premtuara nga organizatori Bledar Jambelli dhe ndërmjetësi Kristaq Leci, në bashkëpunim me këta të fundit, ka vrarë për shkak të detyrës oficerin në lirim të Policisë së Shtetit viktimën Artan Cuku, krim i parashikuar nga nenet 79/b e 25 të KP;

2- Në bashkëpunim me të pandehurit Bledar Jambelli dhe Kristaq Leci, ka mbajtur në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, një armë zjarri luftarake, pistoletë e markës Glock, e kalibrit 9 mm, me numër PCF 695, krim i parashikuar nga nenet 278/1 e 25 të KP, pas ndryshimeve të kryera me ligjin Nr.82/2016, datë 25.7.2016;

3- Në bashkëpunim me të pandehurit Bledar Jambelli dhe Kristaq Leci, ka mbajtur në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, të një arme zjarri luftarake, një pistoletë e markës Zastava, e kalibrit 7.65 mm, me numër 38499, krim

i parashikuar nga nenet 278/1 e 25 të KP, pas ndryshimeve të kryera me ligjin Nr.82/2016, datë 25.7.2016.

Faktet penale të mësipërme kanë ndodhur në hyrjen e pallatit "Melrose", në rrugën e "Kosovarëve" në Tiranë, më 8.4.2017, rreth orës 20.¹⁵; mbajtja e armëve luftarake ka vazhduar për rreth dhjetë ditë, derisa i pandehuri i transportoi dhe i fshehu në shtratin e lumit Devoll, në afërsi të Kuçovës.

I pandehuri e pranon akuzën dhe fajësinë në të gjitha elementet e saj dhe konfirmon se shpjegimet e tij, të dhëna në datën 11.6.2017, të bashkëshoqëruara me regjistrimin audio dhe video, janë të vërteta. Ai konfirmon, gjithashtu, të gjitha shpjegimet e dhëna në vijim, të cilat saktësojnë ose plotësojnë shpjegimet e para të datës 11.6.2017. I pandehuri vetëdeklarohet fajtor dhe shpreh pendim të thellë për krimin e kryer. Nga ana tjetër, ai konfirmon vullnetin për t'u ballafaquar me bashkëpandehurit, si gjatë hetimeve, ashtu edhe në sallën e gjyqit, duke konfirmuar vullnetin e tij për të bashkëpunuar me drejtësinë.




III- PËRCAKTIMI I LLOJIT DHE I MASËS SË DËNIMIT

Në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, palët mbajnë kriteret e ligjit, kontributin e bashkëpunëtorit Mikel Shallari në sqarimin e rrethanave të faktit dhe fajësinë e personave të tjerë, si dhe interesat e trashëgimtarëve të viktimës për drejtësi. Prokurori kërkoi të mbahej parasysh fakti se pasojat e krimit të kryer prej të pandehurit janë shumë të rënda edhe, si për shkak të moshës së re të viktimës, ashtu edhe në raport me gjendjen e tij familjare dhe fëmijët e mitur në ngarkim. Mbi të pandehurin peshojnë rrethanat rënduese të kryerjes së veprës për qëllime fitimi, në bashkëpunim dhe me armë zjarri, sipas shkronjave b), gj) dhe i) të nenit 50 të KP. Nga ana tjetër, prokurori vlerësoi kontributin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, jo në drejtim të fajësisë së tij (për të cilën kishte prova të mjaftueshme), por për sqarimin e bashkëfajësisë të bashkëpandehurve të tjerë Bledar Jambelli (alias Rikardo Muho) dhe Kristaq Leci (alias Gerti Kajo), rolit të tyre dhe motivit të krimit, gjetjes dhe sekuestrimit të armëve dhe provave të tjera mbështetëse ndaj bashkëpandehurve në këtë procedim. Akuza mbajti parasysh faktin se sqarimi i të gjitha rrethanave të krimit, identifikimi i urdhëruesit Jambelli dhe gjetja e provave do të ishte veçanërisht e vështirë pa kontributin e bashkëpunëtorit të drejtësisë. Gjithashtu, u mbajt parasysh edhe arsyeja e ligjit, i cili synon të nxisë bashkëpunimin me drejtësinë, si element shumë i rëndësishëm për parandalimin e krimeve të rënda dhe mbrojtjen e shoqërisë. I pandehuri dhe mbrojtja kërkuan që të mbahet parasysh pendimi i thellë i të pandehurit, kontributi i tij i rëndësishëm në sqarimin e rrethanave dhe gjetjen e provave të krimit dhe jurisprudenca e gjykatave në raste të ngjashme, kur asnjë i penduar i drejtësisë nuk është dënuar me burgim më të rëndë sesa 10 vjet.

Palët ranë dakord përsa vijon:

1- I pandehuri Mikel Shallari të deklarohet fajtor për kryerjen e krimit të vrasjes, për shkak të detyrës, të oficerit në lirim të Policisë së Shtetit, viktimës Artan Cuku, të kryer në bashkëpunim me të pandehurit Bledar Jambelli dhe Kristaq Leci dhe, në bazë të neneve 79/b e 25 të KP dhe 37/b, shkronja dh) të KPP, të dënohet me **10 (dhjetë) vjet burgim**;

2- I pandehuri Mikel Shallari të deklarohet fajtor për kryerjen e krimit të mbajtjes pa leje në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, të një arme zjarri luftarake, pistoletë e markës Glock, e kalibrit 9 mm, me numër PCF 695, kryer në bashkëpunim



me të pandehurit Bledar Jambelli dhe Kristaq Leci dhe, në bazë neneve 278/1 e 25 të KP, pas ndryshimeve të kryera me ligjin Nr.82/2016, datë 25.7.2016, si dhe 37/b, shkronja dh) të KPP, të dënohet me **3 (tre) vjet burgim**;

3- I pandehuri Mikel Shallari të deklarohet fajtor për kryerjen e krimit të mbajtjes pa leje në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, të një arme zjarri luftarake, pistoletë e markës Zastava e kalibrit 7.65 mm, me numër 38499, kryer në bashkëpunim me të pandehurit Bledar Jambelli dhe Kristaq Leci dhe, në bazë neneve 278/1 e 25 të KP, pas ndryshimeve të kryera me ligjin Nr.82/2016, datë 25.7.2016, si dhe 37/b, shkronja dh) të KPP, të dënohet me **3 (tre) vjet burgim**;

4- Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, i pandehuri Mikel Shallari të dënohet me **10 (dhjetë) vjet burgim**.

5- Dënimi të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

IV- DISPONIMI PËR PROVAT MATERIALE

1- Provat materiale të krimit, një pistoletë e markës Glock, e kalibrit 9 mm, me numër PCF 695, e pajisur me një krëhër pa fishekë dhe një pistoletë e markës Zastava, e kalibrit 7.65 mm, me numër 38499, e pajisur me një krëhër pa fishekë, të konfiskohen dhe të kalojnë në pronësi të shtetit;

2- Një bluzë ngjyrë rozë, e markës "pearl & parker", me të cilën ishin mbështjellë armët e krimit, të asgjësohet si send pa vlerë;

3- Prova materiale e sekuestruar në afërsi të vendngjarjes, një bluzë e sipërme sportive, në ngjyrë blu dhe bojëqielli, e markës "Saller", prej së cilës u ekstraktuan profilet e AND-së, të asgjësohet si send pa vlerë;

4- Sendi që lidhet me veprën penale, telefoni Samsung, model "SM-G800F", me numër IMEI "352960061007042", i cili mban kartën SIM të shoqërisë "Vodafone.al", me numër skede 069 773 0041, me kod sigurie XHES1007, i kthehet të pandehurit Mikel Shallari;

5- CD-të e regjistrimit të komunikimeve telefonike që lidhen me të pandehurin Mikel Shallari dhe persona të tjerë që komunikonin me të, të ruhen në fashikullin e gjykatës.

V- SHPËRBLIMI I DËMIT PËR TRASHËGIMTARËT E VIKTIMËS


Duke qenë se trashëgimtarët e viktimës nuk kanë kërkuar të legjitimohen si paditës civilë në procesin penal, dëmi civil i shkaktuar nga krimi nuk është pjesë e kësaj marrëveshjeje.

VI- SHPENZIMET PROCEDURALE

Shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake, në masën 1/3 e tyre, do të paguhen nga i pandehuri Mikel Shallari. Ai detyrohet të paguajë edhe shpenzimet gjyqësore të llogaritura nga gjykata. Kjo aktmarrëveshje redaktohet në dy kopje origjinale me vlerë të njëjtë dhe pas nënshkrimit do të dërgohet për miratim në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda Tiranë, së bashku me të gjitha aktet e hetimeve paraprake Aktmarrëveshja, pasi u lexua, u konfirmua dhe u nënshkrua rregullisht nga palët.


I pandehuri

Mikel Shallari




Mbrojtësi

Av Edlira Naqellari



Prokurori

Henrik Ligor



krim, duke qenë se ndodhej në vështirësi financiare, kishte një të dashur me të cilën bashkëjetonte në një shtëpi me qira, nuk kishte punë stabil për të siguruar të ardhura dhe përberë ishte në borxhe dhe në vështirësi ekonomike. Ai u josh nga premtimet e bashkëpandehurve për t'i siguruar një jetë më të mirë.

I pandehuri pranon se ai nuk e njohte viktimën Artan Cuku; atë ia pati treguar porositësi i krimit, duke shkarkuar një foto të tij nga Interneti dhe duke u bërë të ditur autiomjetet me të cilat lëvizte viktimën dhe vendin ku i parkonte para se të hynte në banesë. I pandehuri Bledar Jambelli pati siguruar edhe armët e krimit. Plani i vrasjes u thurr nga mesi i dhjetëditëshit të tretë të marsit dhe fillimi i prillit 2017; me porosi të organizatorit Bledar Jambelli, i pandehuri, me ndihmën e Kristaq Lecit, e vëzhguan territorin rreth banesës së viktimës dhe e ruajtën atë për të gjetur rastin e volitshëm. Një tentativë u synua të kryhej pasditen e datës 7.4.2017, ku rolin e ekzekutimit e pati marrë përsipër djali i dajës së tij, Kristaq Leci, i veshur me të njëjtat tesha që të nesërmen i veshi i pandehuri. Të dy u pozicionuan tek hapësira me bar përbi parkimit, përballë godinës së universitetit "Marin Barleti", ku mbanin të fshehura edhe armët. E identifikuan viktimën, i cili u ul tek një kafë aty pranë, i pandehuri Leci, me armët në brez, e ndoqi nga pas, por nuk e kreu aktin nga frika e identifikimit, për shkak të lëvizjeve të shumta të njerëzve në atë orë. I pandehuri Shallari shpjegoi sesi ata vëzhgoheshin nga organizatori Jambelli, i cili i nxiti që të qëllonin. Në mbremje vonë, të tre të pandehurit u takuan tek një lokal, ku organizatori me tone fyese, shprehu pakënaqësinë ndaj tyre dhe i nxiti që krimin ta kryenin të nesërmen. I vënë përballë presionit dhe i detyruar për shkak të të faktit se kishte pranuar para nga Jambelli, i pandehuri mori përsipër ta kryente ai ekzekutimin.

I pandehuri ishte orientuar ndërkohë që të ndërronte numrat telefonikë, njëherë në dy ditë. Ai komunikonte vetëm me të pandehurin Leci; me Bledar Jambellin ai nuk ka komunikuar asnjëherë dhe nuk i dinte numrat telefonikë që ai përdorte. Ditën e ngjarjes, më 8.4.2017, ndërsa viktimën po kthehej në banesë, i pandehuri Shallari po e priste para pallatit. Në vendngjarje ai shoqërohej nga i pandehuri Kristaq Leci, i cili priste tek fusha me bar aty pranë dhe e orientonte në distancë me anën e SMS-ve. Pasi viktimën u shfaq dhe u fut në një minimarket pranë hyrjes së pallatit, i pandehuri u pozicionua tek shkallët në pjesën e brendshme të hyrjes dhe me t'u shfaqur viktimën, e qëlloi me të dyja armët njëherësh. Viktimën mbijetoi dhe tentoi të hynte në ashensor, por i pandehuri iu vu pas dhe e qëlloi edhe aty. Më pas, provohet se viktimën doli nga ashensori duke tentuar të përleshje fizikisht me autorin, por i pandehuri e qëlloi përsëri, duke i dhënë goditjen fatale në pjesën e kokës. Pas krimit i pandehuri u largua sipas itinerarit të parapërdhur, tek sheshi "Wilson" prenotoi një taksì, e cila e çoi pranë "Astir"-it, në Utazën e Re (rruga "Teodor Keko"), ku e kishin lënë të takoheshin me bashkëautorët Jambelli dhe Leci.

Në vendtakim u paraqit vetëm i pandehuri Kristaq Leci, kurse Jambelli nuk u paraqit. Pasi e pritën më shumë se një orë, i pandehuri i telefonoi shokut të tij Xhenildo Gogo, duke i kërkuar që të flinte atë natë në apartamentin e tij, në Paskuqan (Tiranë), ku banonte së bashku me shokët e tij, deklaruesit Namik Xhindoli dhe Metjon Demiraj. Megjithatë Gogo refuzoi, se nuk kishte vend mjaftueshëm, të pandehurit Shallari dhe Leci, atë natë bujtën në apartamentin e tij. Ky fakt provohet edhe nga deklaruesit Xhenildo Gogo, Namik Xhindoli dhe Metjon Demiraj, të cilët e njohën gjatë paraqitjes për njohje me fotografi të pandehurin Kristaq Leci. Po atë natë, pranë banesës së Z.Gogo, i pandehuri Shallari theu telefonat celularë të tij dhe të bashkëpandehurit Leci, si dhe zhdukuri kartat SIM të vendosura në ta.

Të nesërmen në mëngjes ata u ndanë nga njëri-tjetri dhe u takuan pasdite, kur i pandehuri Kristaq Leci e kërkoi, nëpërmjet motrës së tij Redona Shallari. Në takim ishte dhe organizatori

me të pandehurit Bledar Jambelli dhe Kristaq Leci dhe, në bazë neneve 278/1 e 25 të KP, pas ndryshimeve të kryera me ligjin Nr.82/2016, datë 25.7.2016, si dhe 37/b, shkronja dh) të KPP, të dënohet me **3 (tre) vjet burgim**;

3- I pandehuri Mikel Shallari të deklarojë fajtor për kryerjen e krimit të mbajtjes pa leje në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, të një arme zjarri luftarake, pistoletë e markës Zastava e kalibrit 7.65 mm, me numër 38499, kryer në bashkëpunim me të pandehurit Bledar Jambelli dhe Kristaq Leci dhe, në bazë neneve 278/1 e 25 të KP, pas ndryshimeve të kryera me ligjin Nr.82/2016, datë 25.7.2016, si dhe 37/b, shkronja dh) të KPP, të dënohet me **3 (tre) vjet burgim**;

4- Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, i pandehuri Mikel Shallari të dënohet me **10 (dhjetë) vjet burgim**.

5- Dënimi të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

IV- DISPONIMI PËR PROVAT MATERIALE

1- Provat materiale të krimit, një pistoletë e markës Glock, e kalibrit 9 mm, me numër PCF 695, e pajisur me një krëhër pa fishekë dhe një pistoletë e markës Zastava, e kalibrit 7.65 mm, me numër 38499, e pajisur me një krëhër pa fishekë, të konfiskohen dhe të kalojnë në pronësi të shtetit;

2- Një bluzë ngjyrë rozë, e markës "pearl & parker", me të cilën ishin mbështjellë armët e krimit, të asgjësohet si send pa vlerë;

3- Prova materiale e sekuestruar në afërsi të vendngjarjes, një bluzë e sipërme sportive, në ngjyrë blu dhe bojëqielli, e markës "Saller", prej së cilës u ekstraktuan profilet e AND-së, të asgjësohet si send pa vlerë;

4- Sendi që lidhet me veprën penale, telefoni Samsung, model "SM-G800F", me numër IMEI "352960061007042", i cili mban kartën SIM të shoqërisë "Vodafone.al", me numër skede 069 773 0041, me kod sigurie XHES1007, i kthehet të pandehurit Mikel Shallari;

5- CD-të e regjistrimit të komunikimeve telefonike që lidhen me të pandehurin Mikel Shallari dhe persona të tjerë që komunikonin me të, të ruhen në fashikullin e gjykatës.

V- SHPËRBLIMI I DËMIT PËR TRASHËGIMTARËT E VIKTIMËS

Duke qenë se trashëgimtarët e viktimës nuk kanë kërkuar të legjitimohen si paditës civilë në procesin penal, dëmi civil i shkaktuar nga krimi nuk është pjesë e kësaj marrëveshjeje.

VI- SHPENZIMET PROCEDURALE

Shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake, në masën 1/3 e tyre, do të paguhen nga i pandehuri Mikel Shallari. Ai detyrohet të paguajë edhe shpenzimet gjyqësore të llogaritura nga gjykata. Kjo aktmarrëveshje redaktohet në dy kopje origjinale me vlerë të njëjtë dhe pas nënshkrimit do të dërgohet për miratim në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda Tiranë, së bashku me të gjitha aktet e hetimeve paraprake Aktmarrëveshja, pasi u lexua, u konfirmua dhe u nënshkrua rregullisht nga palët.

I pandehuri

Mikel Shallari



Mbrojtësi

Av. Edlira Naqellari



Prokurori

Henrik Ligor

